



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 35, Datë 07/05/2024

**“Për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar – personelit akademik, në Komisionin e Zgjedhjeve të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për këtë vend”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7; Vendimit nr. 30, datë 07.05.2024 të KIZ, në mbledhjen e të njëjtës datë, KIZ:

**VENDOSI:**

1. Shpalljen e fillimit të procesit të vetëkandidimit për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar - përfaqësues i Personelit Akademik, të Departamentit të Analitikës dhe Instrumentalizimit, në Komisionin e Zgjedhjeve të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, të UT-së, duke respektuar, për sa mundet parimin e përfaqësimit të njësisë bazë në KZF-në, e njësisë kryesore.
2. Aplikimi i kandidatëve për këto vende, fillon në datën 08.05.2024 dhe përfundon në datën 10.05.2024, nga ora 08:00 – 14:30. Aplikimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ,



pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën [kizut2021@unitir.edu.al](mailto:kizut2021@unitir.edu.al), sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.

3. Ky Vendim dërgohet për zbatim në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, të UT-së.
4. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të UT-së dhe të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, si dhe në të gjitha mjediset e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- |                     |           |
|---------------------|-----------|
| 1. Leticja Gusho    | (Kryetar) |
| 2. Alnida Koroshi   | (Anëtar)  |
| 3. Eljon Doçe       | - //-     |
| 4. Etlon Peppo      | - //-     |
| 5. Shaniko Allajbeu | - //-     |
| 6. Dhurata Saraçi   | - //-     |

